



REPUBLIKA E KOSOVËS /
REPUBLIKA KOSOVA / KOSOVA CUMHURIYETI

C.nr.145/14

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, gjyqtari Arsim Hamzaj, me sekretaren juridike Majlinda Shala, në kontestin e paditësit E. V. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson av. N. Q. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit - Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt të padisë kompensimin e pagesës përcjellëse në pension dhe shpërblimit jubilar, pas marrjes së përgjigjes në padi, më datën 17.10.2014, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit E. V. nga Prizreni, me të cilën kanë kërkuar që të detyrohet e paditura Komuna e Prizrenit- Drejtoria Komunale e Arsimit, që t'ia paguajë paditësit shpërblimin jubilar dhe dy paga përcjellëse me rastin e daljes në pension, si dhe shpenzimet e procedurës, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Në këtë çështje juridike – kontestimore, gjykata vendosi pa shqyrtim kryesor në kuptim të nenit 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së).

Paditësi E. V. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson av.N. Q. nga Prizreni, më datë 10.02.2014 pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit - Drejtoria Komunale e Arsimit, me të cilin ka kërkuar që të detyrohet e paditura Komuna e Prizrenit- Drejtoria Komunale e Arsimit, që t'ia paguajë paditësit shpërblimin jubilar dhe dy paga përcjellëse me rastin e daljes në pension, si dhe shpenzimet e procedurës, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Duke vepruar sipas padisë së paditësit, Gjykata me aktvendimin C.nr.145/14, të datës 01.10.2014 ka obliguar të paditurin që në afat prej 15 dite të paraqes përgjigje në padi.

E paditura Komuna e Prizrenit përmes përfaqësuesit të saj, me parashtrës-përgjigjen në padi të datës 10.10.2014 i ka propozuar gjykatës që padinë e paditësit ta refuzojë si të pa bazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, parashtresës-përgjigjes në padi të të paditurit si dhe shkresave të tjera të lëndës, konform nenit 8 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e **pa bazuar**.

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjykata konstatoi se padia e paditësit ka të bëjë me pagesën e dy pagave për shpërblimin jubilar dhe dy pagave përcjellëse me rastin e pensionimit duke u bazuar në nenin 43 dhe 44 të Kontratës Kolektive, e cila kontratë ka filluar të zbatohet nga data 01.01.2005 dhe zbatimi i saj ka vazhduar për tri vite, përkatësisht deri në vitin 2008, kur të njëjtës i ka skaduar afati dhe pas kësaj kjo kontratë nuk ka veprim të mëtejshëm dhe nuk mund të aplikohet në rastet tjera, ndërsa padia e paditësit është parashtruar më 01.11.2013, andaj kjo gjykatë vendosi që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzojë si të pa bazuar.

Në nenin 399 par.1 të LPK-së është paraparë se “ *Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia*”.

Si përfundim, gjykata vendosi që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzojë si të pa bazuar, pasi që e njehta është në kundërtënie me faktet e treguara në padi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është bazuar konform nenit 450 të LPK-së.

Nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e konform nenit 399 lidhur me nenin 143 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN
C.nr.145/14, datë 17.10.2014

Sekretarja juridike
Majlinda Shala

Gjyqtari
Arsim Hamzaj

KESHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite pas ditës së pranimit të tij, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.